



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosovo za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/05/2022 Ref.: 650/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13.05.2022, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. Kulturë Fizike dhe Sport, BA, 240 ECTS, kampusi në Prishtinë, maksimumi 150 studentë për vit akademik
 2. Stomatologji, Dr Dent, 360 ECTS, kampusi në Prishtinë, maksimumi 30 studentë për vit akademik
 3. Piktura dhe Artet Vizuele, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- II. Akreditohet programi i studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 - I. Dizajn i lojrave dhe animacion, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për ri/akreditim të programeve të studimit. Bazuar në kërkesën e parashtruar, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë

ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB me qëllim të vlerësimit të programeve të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

1. Për programin e studimit: Kulturë Fizike dhe Sport, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, Kolegji AAB si bartës të programit ka paraparë këta persona: Fatmir Pireva, Mimozë Shkodra-Bislimi, Shemsedin Vehapi, Arben Maliqi, Zenel Metaj. Vlerësimi është bërë nga ekspertët ndërkombëtar Chris Richter dhe Delia Gologan. Nga 7 fushat e përgjithshme të përcaktuara me Manualin për Akreditim, ky program studimi ka përbushur në plotni një (1) fushë të përgjithshme dhe ka përbushur substancialisht gjashtë (6) fusha të përgjithshme.
2. Për programin e studimit: Stomatologji, Dr. Dent, 360 ECTS, kampusi në Prishtinë, Kolegji AAB si bartës të programit ka paraparë këta persona: Astrit Kuçi, Avdyl Shoshi, Mimoza Selmani, Bleron Azizi, Teuta Bicaçaj, Donika Ilijazi Shahiqi. Vlerësimi është bërë nga ekspertët ndërkombëtar Joke Denekens, Adrian Tudor Stan dhe Marko Komso. Nga 7 fushat e përgjithshme të përcaktuara me Manualin për Akreditim, ky program studimi ka përbushur në plotni dy (2) fusha të përgjithshme, ka përbushur substancialisht tre (3) fusha të përgjithshme dhe ka përbushur pjesërisht dy (2) fusha të përgjithshme.
3. Për programin e studimit: Piktura dhe Artet Vizuele, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, Kolegji AAB si bartës të programit ka paraparë këta persona: Dita Ethemi, Hektor Vokshi, Fitim Aliu, Sali Musliui, Elisa Nikolla. Vlerësimi është bërë nga ekspertët ndërkombëtar Alan Brickwood dhe Marija Vasilevska. Nga 7 fushat e përgjithshme të përcaktuara me Manualin për Akreditim, ky program studimi ka përbushur në plotni pesë (5) fusha të përgjithshme dhe ka përbushur substancialisht dy (2) fusha të përgjithshme.
4. Për programin e studimit: Dizajn i lojrave dhe animacion, BA, 180 ECTS, kampusi në Prishtinë, Kolegji AAB si bartës të programit ka paraparë këta persona: Clirim Vokshi, Festa Celina, Leart Zogjani. Vlerësimi është bërë nga ekspertët ndërkombëtar Alan Brickwood dhe Marija Vasilevska. Nga 7 fushat e përgjithshme të përcaktuara me Manualin për Akreditim, ky program studimi ka përbushur në plotni pesë (5) fusha të përgjithshme dhe ka përbushur substancialisht dy (2) fusha të përgjithshme.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen Nr.99 të mbajtur më 23.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

